


الاستقامة على دين الله

QËNDRUESHMËRIA NË FENË E ALL-LLAHUT!



Autori:

Salih bin Feuzan el-Feuzan

Përktheu:

Besim Gjellaj

الاستقامة على دين الله

Qëndrueshmëria në fenë e All-llahut!

Autori:

Salih bin Feuzan el-Feuzan

Përktheu:

Besim Gjellaj

Titulli në arabisht: الاستقامة على دين الله

Titulli në shqip: Qëndrueshmëria në fenë e All-Ilahut!

Burimi: <http://www.ajurry.com/vb/showthread.php?t=24988>

Autor: Salih bin Feuzan el-Feuzan

Përkthyes: Besim Gjellaj

Website: www.indeksiislam.com

Të gjitha të drejtat e rezervuara

ان الحمد لله، نحمده ونستعينه ونستغفره، ونعوذ بالله من شرور أنفسنا ومن سيئات أعمالنا، من يهده الله فلا مضلّ له، ومن يضلل فلا هادي له، وأشهد أن لا إله إلا الله وحده لا شريك له، وأشهد أن محمداً عبده ورسوله،

﴿ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ حَقَّ تُقَاتِهِ وَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنتُمْ مُسْلِمُونَ ﴾¹

﴿ يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا زَوْجَهَا وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا وَنِسَاءً وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي تَسَاءَلُونَ بِهِ وَالْأَرْحَامَ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَيْكُمْ رَقِيبًا ﴾²

﴿ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَقُولُوا قَوْلًا سَدِيدًا يُصْلِحْ لَكُمْ أَعْمَالَكُمْ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ فَقَدْ فَازَ فَوْزًا عَظِيمًا ﴾³

أما بعد

فإنَّ أصدق الحديث كلام الله تعالى، وخير الهدي هدي محمدٍ صلى الله عليه وسلّم وشر الأمور محدثاتها، وكلُّ محدثة بدعة، وكلُّ بدعة ضلالة، وكلُّ ضلالة في النار

¹ [آل عمران: 102]

² [النساء: 1]

³ [الأحزاب: 70 - 71]

Qëndrueshmëria në fenë e All-llahut!

Gjitha falënderimet i takojnë All-llahut, Zotit të botëve, ndërsa paqja dhe mëshira e All-llahut qoftë mbi të Dërguarin tonë, Muhamedin salAll-llahu alejhi ue sel-lem, familjen dhe shokët e tij.

Me të vërtetë qëndrueshmëria në dinin e All-llahut do të thotë drejtësi dhe mesatare mes teprimit dhe neglizhencës, mes ashpërsisë dhe butësisë, madje kjo realizohet duke vepruar në përputhshmëri me porosit e librit të All-llahut dhe sunetit të të Dërguarit të Tij salAll-llahu alejhi ue sel-lem, si dhe në përputhshmëri me atë që ishin muslimanët e parë nga ky ymet.

All-llahu i Lartësuar, thotë:

وَأَنَّ هَذَا صِرَاطِي مُسْتَقِيمًا فَاتَّبِعُوهُ وَلَا تَتَّبِعُوا السُّبُلَ فَتَفَرَّقَ بِكُمْ عَنْ سَبِيلِهِ ذَلِكُمْ وَصَّاكُمْ بِهِ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

“Dhe se kjo është rruga (feja) Ime e drejtë (që e caktova për ju), pra përmbajuni kësaj, e mos ndiqni rrugë të tjera e t'ju ndajnë nga rruga e Tij. Këto janë porositë e Tij për ju, ashtu që të ruheni”⁴.

وَأَنَّ هَذَا صِرَاطِي مُسْتَقِيمًا

“Dhe se kjo është rruga (feja) Ime e drejtë (që e caktova për ju)...”

do të thotë: Rruga mesatare.

فَاتَّبِعُوهُ

“pra përmbajuni kësaj...”

ecni në të.

⁴ (En'am 153)

وَلَا تَتَّبِعُوا السُّبُلَ

“e mos ndiqni rrugë të tjera...”

çdo gjë që e kundërshton këtë rrugë nga mendimet, idetë, fjalët si dhe bindjet që janë në kundërshtim me Kur'an-in dhe Sunetin.

هَذَا

“...kjo...”

tregon atë që e ka sjell i Dërguari salAll-llahu alejhi ue sel-lem nga Kur'an-i dhe Syneti.

صِرَاطِي

“...rruga (feja) Ime e drejtë...”

e ka ndërlidh All-llahu me veten e Tij gjë që nënkupton privilegj dhe vlerë, ngase All-llahu është Ai që e bëri legjitime këtë rrugë, si dhe urdhëroi për ta pasuar.

Për këtë thotë:

فَاتَّبِعُوهُ

“...pra përmbajuni kësaj...”

ecni në të deri sa të arrini tek All-llahu dhe tek xheneti i Tij.

وَلَا تَتَّبِعُوا السُّبُلَ

“...e mos ndiqni rrugë të tjera...”

shiko së si All-llahu e bëri të veçuar këtë rrugë, ngase kjo rrugë është e vetme, kurse rrugët e tjera i ka cekur si të shumta ngase ato janë shumë.

Çdo kush që del nga kjo rrugë, me të vërtetë ai zgjedh për vetën e tij rrugën, metodologjinë dhe mënyrën që atij i përshtatet, tjetri zgjedh për veti, e tjetri për veti, kështu që çdo njeri zgjedh rrugën e vet.

Këta pasues të rrugëve të ndryshme nuk bashkohen në një rrugë, por janë në mospajtim ashtu siç janë në mospajtim me atë që e pason rrugën e drejtë të All-Ilahut.

Kurse pasuesit e rrugës së All-Ilahut janë në pajtueshmëri, të unifikuar, të dashur dhe të bashkuar mes veti. Ashtu siç bashkohen në këtë botë në këtë rrugë dhe u deshën mes veti po ashtu do të jenë të bashkuar në xhenet të ulur në kolltukë:

إِخْوَانًا عَلَى سُرُرٍ مُتَقَابِلِينَ

"...e ata në mbështetëse qëndrojnë ballë për ballë njëri-tjetrit duke qenë të vëllazëruar"⁵,

kështu është gjendja e tyre në këtë botë dhe botën tjetër.

Kurse pasuesit e rrugëve të ndryshme, që janë në kundërshtim me rrugën e drejtë, ata jetojnë në mospajtim, armiqësi dhe urrejtje mes veti, në këtë botë, kurse ditën e Kiametit e mallkojnë dhe ofendojnë njeri-tjetrin, çdo njeri prej tyre e akuzon tjetrin, ti me devijove, ti u bërë shkak për këtë e atë, kjo është gjendja e tyre në botën tjetër. All-Ilahu i Lartësuar, thotë:

إِنَّ الَّذِينَ قَالُوا رَبُّنَا اللَّهُ ثُمَّ اسْتَقَامُوا

"E, s'ka dyshim se ata që thanë: "All-Ilahu është Zoti ynë", dhe ishin të paluhatshëm..."⁶,

قَالُوا رَبُّنَا اللَّهُ

"...Ata thanë: All-Ilahu është Zoti ynë..."

do të thotë e dëshmuar publikisht njësimin e All-Ilahut, Zotit të botëve, Ai është Zoti, Ai është i Adhuruari, i Adhuruari i Vetëm i Lartësuar, s'ka të adhuruar tjetër pos Tij, Zoti ynë është All-Ilahu!

⁵ (Hixhr 47)

⁶ (Fussilet 30)

E shprehën këtë haptas, ngase nuk mjafton vetëm besim me zemër pa e shqiptuar me gojë! Madje edhe idhujtarët me zemër e besonin që All-llahu është Zoti i tyre, ai i cili meriton të adhurohet është All-llahu, e besonin këtë zemrat e tyre, mirëpo veprat e tyre janë në të kundërtën me këtë, kjo për shumë arsye, për shkak të hamendjeve, ambicieve, kërkesave, metodologjive dhe grupeve të tyre që ata i pasojnë, kështu që ata vazhdimisht kanë konflikt të brendshëm.

Pasuesit e rrugës së vërtetë janë të pajtuar mes veti gjithnjë, për këtë ka thënë All-llahu i Lartësuar:

ثُمَّ اسْتَقَامُوا

“...dhe ishin të paluhatshëm...”

Fjala:

قَالُوا رَبَّنَا اللَّهُ

“All-llahu është Zoti ynë...”

me këtë e shprehën qëndrimin e tyre, pastaj e pasuan fjalën më vepër, pastaj u përqendruan në fenë e All-llahut dhe thanë:

قَالُوا رَبَّنَا اللَّهُ

“All-llahu është Zoti ynë...”

që do të thotë e besuan me zemrat e tyre, dhe nuk ishte vetëm dëshmi me gjuhë, por e besuan bindshëm edhe me zemër dhe i kryen veprat. Iu nënshtruan urdhrave të All-llahut dhe u përmbajtën ndalesave të Tij, ecën sipas ligjit dhe fes së Tij, njëherë kjo është qëndrueshmëria në të vërtetën.

U përqendruan në të, ngase nuk mjafton fjala pa vepër, ka disa që thonë Zoti ynë është All-llahu, pastaj lajthitin nga kjo, siç thotë All-llahu i Lartësuar:

وَمِنَ النَّاسِ مَنْ يَقُولُ آمَنَّا بِاللَّهِ وَيَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَمَا هُمْ بِمُؤْمِنِينَ * يُخَادِعُونَ اللَّهَ وَالَّذِينَ آمَنُوا وَمَا يَخْدَعُونَ إِلَّا أَنْفُسَهُمْ وَمَا يَشْعُرُونَ

“Ka disa njerëz që thonë: "Ne i kemi besuar All-llahut dhe jetës tjetër (Ahiretit), po në realitet ata nuk janë besimtarë. Ata përpiqen ta mashtrojnë All-llahun dhe ata që besuan, po në të vërtetë ata nuk mashtrojnë tjetër, pos vetvetes, por ata nuk e hetojnë”⁷.

Të tillët janë dyfytyrësh të cilët thonë Zoti ynë është All-llahu haptas, mirëpo nuk përqendrohen në të vërtetën me besim dhe me vepra:

فَإِذَا أُذِيَّ فِي اللَّهِ جَعَلَ فِتْنَةَ النَّاسِ كَعَذَابِ اللَّهِ

“...e kur goditet me ndonjë të keqe për shkak të (rrugës së) All-llahut, ai sprovimin prej njerëzve e trajton si dënimin e All-llahut..”⁸,

devijon nga e vërteta si shkak i frikës nga njerëzit, nuk e paramendon së ndëshkimi i All-llahut është me i rëndë së sa demi i njerëzve, ik nga tigani dhe bien në zjarr, All-llahu na ruajttë!

وَمِنَ النَّاسِ مَنْ يَقُولُ آمَنَّا بِاللَّهِ وَيَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَمَا هُمْ بِمُؤْمِنِينَ

“Ka disa njerëz që thonë: "Ne i kemi besuar All-llahut dhe jetës tjetër (Ahiretit), po në realitet ata nuk janë besimtarë”

⁷ (Bekare 8-9)

⁸ (Ankebut 10)

është thjesht një pretendim, e asgjë me shumë, nuk është përqendrim në të vërtetën, por thjesht një pretendim, të tillët janë dyfityrëshit, këta janë:

فِي الدَّرَكِ الْأَسْفَلِ مِنَ النَّارِ وَلَنْ تَجِدَ لَهُمْ نَصِيرًا

“S'ka dyshim, munafikët do të jenë në shtresën më të ulët (në fund) të zjarrit...”⁹.

قَالُوا رَبَّنَا اللَّهُ ثُمَّ اسْتَقَامُوا تَتَنَزَّلُ عَلَيْهِمُ الْمَلَائِكَةُ

“E, s'ka dyshim se ata që thanë: "All-llahu është Zoti ynë", dhe ishin të paluhatshëm, atyre u vijnë engjëjt (në prag të vdekjes dhe u thonë)...”

do të thotë kjo ndodh në prag të vdekjes, zbresin melajket për ta marrë shpirtin, iu shfaqen dhe i përgëzojnë me shpërblime të mira, i qetësojnë nga brengat që i kanë për pasardhësit e tyre si dhe për gjitha gjërat që i kanë lan pas tyre në këtë botë.

تَتَنَزَّلُ عَلَيْهِمُ الْمَلَائِكَةُ

“...atyre u vijnë engjëjt (në prag të vdekjes dhe u thonë)...”,

iu thonë atyre mos u frikësoni për atë që iu pretë, ngase ju jeni duke vazhduar drejt xheneteve dhe drejt kënaqësisë së All-llahut të Lartësuar, drejt kënaqësisë së përhershme, kështu që mos u frikësoni ngase ju e siguroat të ardhmen tuaj sa ishit gjallë, punuat atë që ju bëri të sigurt ditën e Kiametit, mos u pikëlloni për atë që e keni len në dynja, siç është pasuria dhe fëmijët, sepse ajo që gjendët tek All-llahu është me e mirë dhe me e përhershme.

⁹ (Nisa 145)

وَأَبَشِّرُوا بِالْجَنَّةِ

“...keni myzhde xhennetin...”,

pasi që i qetësuan, atëherë i përgëzuan “...keni myzhde xhennetin që u premtohet”.

نَحْنُ أَوْلِيَاؤُكُمْ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَفِي الْآخِرَةِ وَلَكُمْ فِيهَا مَا تَشْتَهِي أَنْفُسُكُمْ
وَلَكُمْ فِيهَا مَا تَدْعُونَ

“(u thonë) Ne kujdesemi për ju, si në jetën e kësaj bote, ashtu edhe në botën tjetër, kudo të keni atë që dëshironi dhe gjithçka kërkonit”¹⁰,

atë që ju e kërkonit.

نُزُلًا مِنْ غَفُورٍ رَحِيمٍ

“Pritje e nderuar prej Atij që falë mëkatet dhe që është mëshirues!”¹¹,

ky është vendi i tyre në ditën e Kiametit, në të kundërtën me vendin e pa besimtarëve dhe përgenjeshtruesve, vendi i tyre është xhehenemi, All-llahu na ruajttë!

وَأَبَشِّرُوا بِالْجَنَّةِ الَّتِي كُنْتُمْ تُوعَدُونَ نَحْنُ أَوْلِيَاؤُكُمْ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَفِي
الْآخِرَةِ

“...keni myzhde xhennetin që u premtohet. (u thonë) Ne kujdesemi për ju, si në jetën e kësaj bote...”¹²,

kjo është në Kur’an dhe në Sunet, ka thënë i Dërguari salAll-llahu alejhi ue sel-lem: “**Përqendrohuni në të vërtetën dhe mos mendoni që mundeni plotësisht të përqendroheni**”, mos llogaritni që çdo gjë që e ka urdhëruar që ju ta veproni, ndonjëherë njeriu ka mangësi, në disa aspekte njeriu ka mangësi, mirëpo kjo mangësi iu falet juve.

¹⁰ (Fusilet 31)

¹¹ (Fusilet 32)

¹² (Fusilet 30-31)

“Përqendrohuni në të vërtetën dhe mos mendoni që mundeni plotësisht të përqendroheni”, nuk mundet njeriu që t’i kryej gjitha obligimet, s’ka mundësi që mos t’i mbet diçka pa e kryer, kjo është e pamundshme, mirëpo përqendrohet me aq sa ka mundësi.

لَا يُكَلِّفُ اللَّهُ نَفْسًا إِلَّا وُسْعَهَا

“All-llahu nuk e obligon asnjë njeri përtej mundësisë së tij...”¹³,

Pejgamberi, salAll-llahu alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Bën përpjekje t’ia qëlloni të drejtës dhe nëse nuk mundeni atëherë afrojuni asaj”** që do të thotë qëllojeni të drejtën e nëse nuk mundeni atëherë afrohuni sa ma afër saj.

“Përqendrohuni në të vërtetën dhe mos mendoni që mundeni plotësisht të përqendroheni, bën përpjekje t’ia qëlloni të drejtës dhe nëse nuk mundeni atëherë afrojuni asaj, dijeni që puna me e mirë e juaj është namazi”, po ashtu All-llahu i Plotfuqishëm i ka thënë të Dërguarit të Tij:

فَاسْتَقِمْ كَمَا أُمِرْتَ

“Ti (Muhammed) përqendrohu vendosmërisht ashtu si je i urdhëruar...”¹⁴,

do të thotë përqendrimi duhet të jetë varësisht prej urdhrit apo ndalesës së ligjit të All-llahut, njeriu nuk sjell adhurime apo gjëra prej vetvetes duke menduar së i afrohet All-llahut.

¹³ (Bekare 286)

¹⁴ (Hud 112)

فَاسْتَقِمْ كَمَا أُمِرْتَ وَمَنْ تَابَ مَعَكَ

“Ti (Muhammed) përqendrohu vendosmërisht ashtu si je i urdhëruar, e bashkë me ty edhe ata që u penduan (prej idhujtarisë)...”¹⁵,

edhe ata (besimtarët) të përqendrohen gjithashtu siç janë urdhëruar.

فَاسْتَقِمْ كَمَا أُمِرْتَ وَمَنْ تَابَ مَعَكَ وَلَا تَطْغَوْا

“Ti (Muhammed) përqendrohu vendosmërisht ashtu si je i urdhëruar, e bashkë me ty edhe ata që u penduan (prej idhujtarisë), e mos tejkaloni (kufijtë e caktuar)...”¹⁶,

ndalohet teprimi, mos të thotë unë jam përqendruar pastaj ta teproj sa që të dal nga përqendrimi dhe të kaloj në teprim.

فَاسْتَقِمْ كَمَا أُمِرْتَ وَمَنْ تَابَ مَعَكَ وَلَا تَطْغَوْا إِنَّهُ بِمَا تَعْمَلُونَ بَصِيرٌ

“Ti (Muhammed) përqendrohu vendosmërisht ashtu si je i urdhëruar, e bashkë me ty edhe ata që u penduan (prej idhujtarisë), e mos tejkaloni (kufijtë e caktuar), se më të vërtetë Ai është shikues i asaj që veproni”¹⁷.

All-llahu i Lartësuar në një ajet tjetër thotë:

فَاسْتَقِيمُوا إِلَيْهِ وَاسْتَغْفِرُوهُ

“...pra drejtojuni Atij dhe kërkon falje prej Tij...”¹⁸,

drejtojuni Atij duke e pasuar dhe ndjekur rrugën e Tij, kërkon falje për mangësitë tuaja, ngase njeriu ka mangësi, mirëpo këtë e eliminon duke kërkuar falje.

¹⁵ (Hud 112)

¹⁶ (Hud 112)

¹⁷ (Hud 112)

¹⁸ (Fusilet 6)

Pra:

فَاسْتَثِقِمُوا إِلَيْهِ وَاسْتَغْفِرُوهُ

“...pra drejtojuni Atij dhe kërkoni falje prej Tij...”¹⁹.

فَاسْتَثِقِمْ كَمَا أَمَرْتُ وَمَنْ تَابَ مَعَكَ وَلَا تَطْغَوْا

“Ti (Muhammed) përqendrohu vendosmërisht ashtu si je i urdhëruar, e bashkë me ty edhe ata që u penduan (prej idhujtarisë), e mos tejkaloni (kufijtë e caktuar)...”²⁰,

kjo nënkupton që shtimi në fe është i ndaluar si dhe teprimi në të.

فَاسْتَثِقِمُوا إِلَيْهِ وَاسْتَغْفِرُوهُ

“...pra drejtojuni Atij dhe kërkoni falje prej Tij...”²¹,

ky është një urdhër që t’i kërkojmë falje për mangësitë në përqendrim, ngase njeriu i ekspozohet mangësive pa marr parasysh sa mundohet, për këtë ka thënë Pejgamberi salAll-llahu alejhi ue sel-lem: **“...dhe nëse nuk mundeni atëherë afrojuni asaj...”**, kërkimi i faljes i largon mangësitë.

All-llahu i Plotfuqishëm na ka urdhëruar që t’i lutemi në çdo rekat të namazit tonë kur ne e këndojmë suren el-Fatiha, ku në fund të saj thuhet:

اهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ

“Udhëzona në rrugën e drejtë”²²,

ti pra kërkon prej All-llahut që te të udhëzoj, udhëzim dhe përforcim në rrugën e drejtë, për cilën rrugë? All-llahu i lartësuar ka thënë:

¹⁹ (Fusilet 6)

²⁰ (Hud 112)

²¹ (Fusilet 6)

²² (Fatiha 6)

وَأَنَّ هَذَا صِرَاطِي مُسْتَقِيمًا فَاتَّبِعُوهُ

**“Dhe se kjo është rruga (feja) Ime e drejtë (që e caktova për ju),
pra përmbajuni kësaj...²³,**

i kërkon All-llahut që ta qartësoi të vërtetën, te të udhëzoi në të, si dhe të përforcoi në rrugën e drejtë:

صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ

“Në rrugën e atyre, të cilët i begatove me të mira...”²⁴.

Na e bëri të qartë All-llahu i Plotfuqishëm së cilët janë ata që All-llahu i begatoj me mirësitë e Tij në ajetin e Tij:

وَمَنْ يُطِغِ اللَّهَ وَالرَّسُولَ فَأُولَٰئِكَ مَعَ الَّذِينَ أَنْعَمَ اللَّهُ عَلَيْهِمْ مِنَ النَّبِيِّينَ
وَالصِّدِّيقِينَ وَالشُّهَدَاءِ وَالصَّالِحِينَ وَحَسُنَ أُولَٰئِكَ رَفِيقًا

“E kush do që i bindet All-llahut dhe të dërguarit, të tillët do të jenë së bashku me ata që All-llahu i shpërbleu: (me) pejgamberët, besnikët e dalluar, dëshmorët dhe me të mirët. Sa shokë të mirë janë ata!”²⁵,

nëse ti i nënshtrohesh All-llahut dhe të Dërguarit të Tij do të jesh me këta njerëz, nuk do të turpërohesh as në dynja e as në ahiret, këta janë shoqëruesit e mirë:

وَحَسُنَ أُولَٰئِكَ رَفِيقًا

“...Sa shokë të mirë janë ata!”²⁶,

shoqërues në këtë rrugë, ngase ai i cili ec në rrugë ka nevojë për shoqërues që e ndihmon dhe e afron, e shoku yt i tillë konsiderohet prej me të zgjedhurve nga mesi i robërve të All-llahut.

²³ (En'am 153)

²⁴ (Fatiha 7)

²⁵ (Nisa 69)

²⁶ (Nisa 69)

غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ

“...jo në të atyre që kundër veti tërhoqën hidhërimin, e as në të atyre që e humbën veten!”²⁷,

kërkon prej All-llahut që të ruaj nga rruga e çifutëve si dhe gjithë atyre që ecin hapave të tyre, që bëjnë tolerime dhe lëshime nga rruga e All-llahut.

وَالضَّالِّينَ

“...e as në të atyre që e humbën veten!”²⁸,

ata janë që e tepruan, siç janë të krishterët dhe gjithë ata që ecin rrugës së tyre, ti pra kërko nga All-llahu që te të udhëzoi në rrugën e drejtë, te të ruaj nga rruga e atyre që është i Hidhëruar ndaj tyre, nga rruga e çifutëve dhe atyre që ecin hapave të tyre, të cilët mësuan dhe nuk veprouan, bënë tolerime në vepër, si dhe të ruaj nga rruga e atyre që humbën, të cilët nuk mësuan dhe vazhduan duke e tepruar, të tillët janë të krishterët që e shpiken murgërinë, kjo është një çështje shumë e rëndësishme që duhet të kemi kujdes shumë!

Këtë nuk mund ta dimë përveç nëse e mësojmë diturinë e sheriatit, duke i mësuar çështjet në detaje, të bazuar në Kur'an dhe Sunet te të Dërguarit salAll-llahu alejhi ue sel-lem.

Patjetër duhet mësuar së pari, pastaj duhet punuar dhe duhet përqendruar në të.

Disa thërrasin në lehtësime, disa në ekstremizëm, disa nga grupacionet thërrasin në ekstremizëm dhe teprim, përball këtyre disa thërrasin në lehtësime dhe neglizhime etj.

Të jemi të kujdesshëm nga këta e nga ata, të ruhemi nga ata që e tepruan dhe thërrasin në ekstremizëm, po ashtu të ruhemi nga ata që bëjnë lehtësime dhe neglizhime, të jemi mesatar dhe të drejtë, të jemi me ata të cilët ndjekin rrugën që All-llahu i begatoi, prej pejgamberëve, besnikët, dëshmorëve dhe të drejtëve, sa shoqëri e mirë është kjo!

²⁷ (Fatiha 7)

²⁸ (Fatiha 7)

All-llahu i Madhërishëm, thotë:

وَالسَّائِقُونَ الْأَوَّلُونَ مِنَ الْمُهَاجِرِينَ وَالْأَنْصَارِ وَالَّذِينَ اتَّبَعُوهُمْ بِإِحْسَانٍ
رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ وَرَضُوا عَنْهُ وَأَعَدَّ لَهُمْ جَنَّاتٍ تَجْرِي تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ
فِيهَا أَبَدًا ذَلِكَ الْقَوْرُ الْعَظِيمُ

“All-llahu është i kënaqur me të hershmit e parë prej muhaxhirëve (migruesve) dhe prej ensarëve (vendasve-ndihmëtarë) dhe prej atyre që i pasuan ata me punë të mira, e edhe ata janë të kënaqur ndaj Tij. Atyre u ka përgatitur xhennete, në të cilët rrjedhin lumenj, ku do të jenë përjetë të pasosur. E ky është fitim i madh”²⁹.

وَالسَّائِقُونَ الْأَوَّلُونَ مِنَ الْمُهَاجِرِينَ وَالْأَنْصَارِ

“All-llahu është i kënaqur me të hershmit e parë prej muhaxhirëve (migruesve) dhe prej ensarëve (vendasve-ndihmëtarë)...”,

këta janë sahabët e të Dërguarit salAll-llahu alejhi ue sel-lem.

اتَّبَعُوهُمْ بِإِحْسَانٍ

“...dhe prej atyre që i pasuan ata me punë të mira...”

i pasuan me përpikëri, duke mos e tepruar dhe duke mos dalë nga rruga e muhaxhirëve dhe ensarëve, nuk bënë lehtësime dhe kështu me dalë nga rruga e tyre, kjo është puna e mirë, veprim me përpikëri.

Praktikimi i rrugës së tyre nuk bëhet ndryshe përveç së me mësimin e rrugës dhe gjendjes së tyre, duke e mësuar këtë hollësisht, përndryshe:

“Të gjithë pretendojnë së kanë lidhje më Lejlen mirëpo Lejla nuk e pohon një gjë të tillë”.

²⁹ (Teube 100)

Të gjithë pretendojnë që janë në rrugën e muhaxhirëve dhe ensarëve, mirëpo realitet i tyre, sjellja e tyre e kundërshton këtë pretendim, personi i tillë ose është injorant ndaj rrugës së tyre dhe mendon së ajo rrugë është rrugë ekstreme apo e butë, ose ky person e pason epshin e tij në realitet, edhe pse pretendon që i pason muhaxhirët dhe ensarët, ky më të vërtetë e pason epshin e tij, ose ka mundësi që ecë në atë projekt që armiq të tij që shfaqën si musliman dhe thirrës islam e kanë projektuar jo sipas rrugës së muhaxhirëve dhe ensarëve.

Ai i cili largohet nga rruga e muhaxhirëve dhe ensarëve, ai ose është injorant ndaj rrugës së tyre, ose pasues i epshit të tij ose hamendjes së të tjerëve që i pason verbërisht dhe ec hapave të tyre.

Nga kjo çështje duhet patjetër të ruhem, aktualisht të gjithë e dini së ka njerëz që kanë bindje ekstreme, bartin ide ekstreme, të tepërta, kryejnë veprime tmerruese në emër të xhihadit sipas mendimit të tyre!

I vrasin muslimanët dhe jomuslimanët që kanë hyrë brenda shtetit islam me leje, gjakun e të cilëve e ka bërë haram All-llahu, i marrin jetën njeriut të cilin jetë e ka ndaluar All-llahu marrjen e saj, në emër të xhihadit, krejt kjo si shkak i rezultatit të ekstremizmit dhe mos kuptimit të mirëfilltë të fesë së All-llahut të Plotfuqishëm.

Në anën tjetër disa janë shumë tolerant, sa që dëshirojnë që njerëzit të dalin nga feja, të mbesin musliman vetëm me emër, të mbesin musliman sipas hamendjeve të tyre, dëshirave të tyre apo sipas dëshirave të prijësve të tyre, hoxhallarëve, grupeve të cilave ju takojnë, sipas tyre mjafton të quhet vetëm në emër të fesë edhe nëse ec në kundërshtim me parimet e fesë!

Ky është një rrezik i madh që i ka kapluar rinin tonë, disa janë tolerant e disa janë ekstrem, kurse ajo që kërkohet është mesatarja dhe drejtësia, kjo është rruga e shpëtimit, rruga e mesatares dhe drejtësisë, kjo nuk arrihet ndryshe përveç se duke mësuar, arrihet duke mësuar diturin e dobishme e cila udhëzon për rrugën e pastër, rrugën e drejtë e cila është e bazuar nga libri i All-llahut dhe suneti i të Dërguarit të Tij, jo nga fjalët e filanit e filanit, mirëpo bazohet në Kur'an dhe Sunet.

Largohu nga fjalët ekstreme dhe boshe, largohu prej tyre dhe mos u mashtro pas tyre, ju jeni në këtë universitet të begatshëm, në vendin ku mund ta mësoni rrugën e selefit, rruga e cila është rruga e drejtë, ju me lejen e Zotit jeni në këtë menhexh.

Andaj, mësoni, mësoni dituri të dobishme përmes së cilës ju ecni në këtë rrugë të drejtë dhe e dine së çfarë e kundërshton këtë rrugë nga pretendimet e rrejshme, këto pretendime të rrejshme janë veshur me petkun e islamit, fjalë të zbukuruar mashtroese, andaj bëhuni të kujdesshëm!

Ju po dëgjoni, po ashtu po lexoni së çfarë po shkruhet nëpër gazeta nga gjërat e turpshme, janë asket ndaj diturisë së dobishme, e cilësojnë si ekstremizëm, thërrasin në tolerancë dhe në gjitha ato gjëra që ata i quajnë pjesë e tolerancës, thërrasin në lirin e grupeve, në shprehjen e mendimit të lirë, thërrasin e thërrasin, dëshirojnë t'i nxjerrin njerëzit nga rruga e drejtë.

Çështja nuk ka të bëjë me shprehje apo mendime, çështja ka të bëjë me Kur'an dhe Sunet. Po, ka mundësi të ndodhin mospajtime, ndodh me pas mendime dhe shprehje të ndryshme, ndonjëherë me qellim të mirë e ndonjëherë me qellim të keq. Kjo ndodh. Mirëpo kjo na ndihmon neve që ta dallojmë të vërtetën nga e keqja, të dëmshmen nga e dobishmja, të vërtetën nga e keqja, e ky është Kur'an-i dhe Suneti, All-llahu i lartësuar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا أَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ وَأُولِي الْأَمْرِ مِنْكُمْ فَإِنْ تَنَازَعْتُمْ فِي شَيْءٍ فَرُدُّوهُ إِلَى اللَّهِ وَالرَّسُولِ

“O ju që besuat, binduni All-llahut, respektoni të dërguarin dhe përgjegjësit nga ju. Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashtrojeni atë te All-llahu (te libri i Tij) dhe te i dërguari...”³⁰,

parashtrimi tek All-llahu do të thotë kthimi tek libri i Tij, kurse tek Pejgamberi është për qellim kthimi tek ai sa ka qenë gjallë, kurse pas vdekjes kthimi tek suneti i tij salAll-llahu alejhi ue sel-lem.

³⁰ (Nisa 59)

فَرَّذُوهُ إِلَى اللَّهِ وَالرَّسُولِ إِنْ كُنْتُمْ تُؤْمِنُونَ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ ذَلِكَ خَيْرٌ
وَأَحْسَنُ تَأْوِيلًا

“...atëherë parashtrojeni atë te All-llahu (te libri i Tij) dhe te i dërguari, po qe se i besoni All-llahut dhe ditës së fundit. Kjo është me e dobishmja dhe përfundimi me i mirë”³¹,

do të thotë kthimi dhe përfundimi në të ardhmen është me i mirë.

Pejgamberi, salAll-llahu alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Ai i cili do të jetoj do të shoh mospajtime të shumta, andaj përmbajuni sunetit tim dhe sunetit të prijësve të drejtë që vinë pas meje, kapuni për këtë fuqishëm, ruajuni nga risit, ngase çdo risi është bidat dhe çdo bidat është lajthitje”.**

Kjo është porosia e të Dërguarit salAll-llahu alejhi ue sel-lem në rastin e mospajtimeve, po ashtu na ka treguar së do të ndodhin mospajtime, mirëpo peshorja e kësaj ekziston, falënderimi i takon All-llahut për këtë mirësi, peshore përmes së cilës e njohim të vërtetën nga e kota, gabimin nga e sakta!

Që do të thotë gjitha i ekspozojmë kah libri i All-llahut dhe Suneti i të Dërguarit salAll-llahu alejhi ue sel-lem dhe veprojmë me dituri dhe çiltërsi.

Mësojmë nga libri i All-llahut dhe nga Suneti i të Dërguarit salAll-llahu alejhi ue sel-lem atë që përmes saj e dallojmë të vërtetën dhe jo të vërtetën, patjetër që duhet ta kemi parasysh këtë çështje.

Tanimë ju po dëgjoni së disa kanë ndërhyrë në çështje të akides (besimit) dhe filluan t’i mohojnë disa çështje të saj, që janë pjesë e akides së selefite, emrat dhe cilësitë e All-llahut, ndalimin e adhurimit të varrezave, apo çështjeve tjera që konsiderohen si shirk, e quajnë ekstremizëm dhe shtrembërim të së vërtetës!!! E shumë e shumë gjëra tjera.

Ndërhynë në çështjet e grave për të drejtat e të cilave ka folur Pejgamberi salAll-llahu alejhi ue sel-lem në haxhin e lamtumirës.

³¹ (Nisa 59)

I Dërguari salAll-llahu alejhi ue sel-lem na ka porositur: **“Silluni mirë më gratë”, “Nuk kam lënë sprovë pas meje me të dëmshme për burrat sesa sprova e grave”, “Ruajuni nga sprova e grave, ngase sprova e parë që është shfaqur tek Beni Israilet ishte sprova e grave”.**

Thërrasin që gruaja ta hekë mbulesën e saj, të zhvishet, të udhëtoi vetëm pa të afërmit e saj, të marr pozitën e burrave, e konsiderojnë ekstremizëm, e urrejnë ndalesën e përzierjes së burrave dhe grave, e konsiderojnë ekstremizëm, teprim, nënçmim dhe padrejtësi ndaj gruas!

Nuk e dinë që padrejtësi ndaj gruas është kur ajo vendoset aty ku së ka vendin, t’i obligosh diçka që s’mund ta kryej, ta ekspozosh ndaj fitnes (sprovave), ta nxjerrësh nga shtëpia pa kurrfarë arsye dhe pa kurrfarë parimi sheriatik, kjo është padrejtësi!

Pastaj, All-llahu i Lartësuar në Kur’an kur përmend kohën e pritjes së grave (idetit), e bëri të njëjtë kohën e atyre që nuk kanë ende cikël mujorë më ato që iu ka kaluar periudha e tyre, duke pritur tre muaj:

وَاللَّائِي يَئْسَنَ مِنَ الْمَحِيضِ مِنْ نِسَائِكُمْ إِنْ ارْتَبْتُمْ فَعِدَّتُهُنَّ ثَلَاثَةُ أَشْهُرٍ
وَاللَّائِي لَمْ يَحِضْنَ

“E ato nga gratë tuaja të cilave u është ndërprerë cikli mujor (menstruacioni) nëse nuk e keni ditur, koha e pritjes së tyre është tre muaj, e ashtu edhe ato që ende nuk kanë pasur menstruacion...”³².

Koha e pritjes së vajzave të reja është tre muaj nëse shkurorëzohen para paraqitjes së ciklit mujorë, kjo tregon së lejohet martesë me të reja, kjo është e vërtetë, kjo është e pohuar në librin e All-llahut të Lartësuar.

Kurse këta njerëz e mohojnë atë që është pohuar në sunetin e të Dërguarit salAll-llahu alejhi ue sel-lem, po ashtu e mohojnë edhe atë që është pohuar në librin e All-llahut ashtu siç është dielli i dukshëm në mesin e qiellit.

³² (Talak 4)

Qëllimi i tyre me këtë qëndrim është dhënia e lirisë ndaj gruas, liri e falsifikuar e cila konsiderohet padrejtësi në realitet dhe humbje ndaj saj!

Kujdes ndaj ndërhyrjeve të tyre, fjalëve të tyre dhe dëshirave, ju paralajmëroi nga ndërhyrjet e këtyre ideve në këtë universitet.

Përkundrazi është obligim për mësimdhënësit, studentët dhe punëtorët tjerë që t'i kundërshtojnë këto ide, haptas të flasin kundër tyre, ngase ky universitet është fortifikata mbrojtëse me lejen e All-llahut kundër këtyre ideve dhe ideve të tjera të ngjashme.

Ky universitet trashëgon dituri, besim të mirëfilltë, bazat e të cilës i ka vendosur prijësi i muslimanëve, mbreti Abdul-Aziz, All-llahu e mëshiroftë, në bashkëpunim me shkelqesinë, shejhun Muhamed ibën Ibrahim, All-llahu e mëshiroftë.

I vunë planë programe të thella të forta të cilat i ruajnë bijtë e tyre dhe i nxjerrin kuadrot që janë të përshtatshëm për shoqërinë, kuadro që bartin dituri dhe veprojnë, janë adekuat në aspektin administrativ, me të vërtetë kjo është kalaja mbrojtëse!

Duhet t'i sfidojmë këto ide, mësimdhënësit duhet t'i sfidojnë këto ide në sallat e mësimi, t'i demantojnë para studentëve, po ashtu studentët duhet të kthehen tek mësimdhënësit e tyre të pyesin për to derisa të kuptojnë së kush qëndron pas këtyre ideve që mundohen t'i fusin në mesin e tyre dhe t'i humbin ose ata janë duke jetuar në një botë të humbur, kështu që t'i ruan All-llahu nga sherri dhe kurthet e tyre dhe t'i kthej këto në supet e tyre.

Obligimi jonë është shumë i madh, o ju vëllezër, All-llahu i Lartësuar thotë:

إِنَّ الَّذِينَ قَالُوا رَبُّنَا اللَّهُ ثُمَّ اسْتَقَامُوا

"E, s'ka dyshim se ata që thanë: "All-llahu është Zoti ynë", dhe ishin të paluhatshëm..."³³.

Patjetër duhet t'i kemi parasysh dy çështje:

1. të dëshmojmë haptazi së Zoti ynë është All-llahu, të themi së nuk ka të adhuruar më të drejtë përveç All-llahut;
2. të besojmë bindshëm me zemër, ta praktikojmë në vepër, mos të bëhemi sikur ata që thanë Zoti ynë është All-llahu kurse veprat i kishin në të kundërtën e asaj që e pretendonin.

All-llahu i Lartësuar thotë:

وَمِنَ النَّاسِ مَنْ يَقُولُ آمَنَّا بِاللَّهِ وَيَاْلَيُومِ الْآخِرِ وَمَا هُمْ بِمُؤْمِنِينَ * يُخَادِعُونَ اللَّهَ وَالَّذِينَ آمَنُوا وَمَا يَخْدَعُونَ إِلَّا أَنْفُسَهُمْ وَمَا يَشْعُرُونَ

"Ka disa njerëz që thonë: "Ne i kemi besuar All-llahut dhe jetës tjetër (Ahiretit), po në realitet ata nuk janë besimtarë. Ata përpiqen ta mashtrojnë All-llahun dhe ata që besuan, po në të vërtetë ata nuk mashtrojnë tjetër, pos vetvetes, por ata nuk e hetojnë"³⁴.

Kjo ishte e gjitha, e lus All-llahun e Plotfuqishëm që të na jep sukses për dituri të dobishme dhe punë të mirë neve dhe juve! Paqja dhe mëshira e All-llahut qoftë mbi të Dërguarin tonë, Muhamedin, salAll-llahu alejhi ue sel-lem, familjen dhe shokët e tij në përgjithësi!

³³ (Fusilet 30)

³⁴ (Bekare 8-9)

Pyetjet

1. **Pyetje:** All-llahu ju dhashtë sukses, si t'i kundërpërgjigjemi atyre që thonë: Si na ka lënë i Dërguari salAll-llahu alejhi ue sel-lem në rrugë të pastër, kurse mospajtimet në çështje sheriatike janë prezentë akoma?

Përgjigjja: Po, na ka lënë në rrugën e pastër përmes së cilës e mësojmë së çfarë është mospajtim, cila është e vërtetë e cila e kotë, pastaj e pasojmë të vërtetën dhe largohemi nga e kota, Pejgamberi, salAll-llahu alejhi ue sel-lem, ka thënë: **"I kam lënë dy gjëra, nëse kapeni pas tyre, kurrë s'do të humbni, ato janë libri i All-llahut, Kur'an-i dhe Suneti im"** po.

2. **Pyetje:** I nderuari shejh: A lejohet për kërkuesin e dijes i cili i ka mësuar çështjet e tekfirit, që ta bëjë pa besimtar ndonjë person konkret pa i pyetur dijetarët, vetëm duke u bazuar në diturin që ai e posedon në lidhje me çështjet e tekfirit?

Përgjigjja: Çështjet e tekfirit janë shumë të rrezikshme, janë rrëshqitje e këmbeve dhe lajthitje e mendjeve, duhet që të pyeten dijetarët për to, assesi nuk bënë t'i thuhet pa besimtar dikujt përveç nëse sjellët para gjykatës sheriatike, pastaj aty analizohet çështja e tij, qofshin fjalët apo punët e tij dhe tek pastaj bëhet pa besimtar.

Kurse çdokush të bëjë tekfir?! Kjo nuk lejohet. Po. Mirëpo në mënyrë të përgjithshme mund të thuash kush e bënë këtë është pa besimtar, apo kush thotë kështu është pa besimtar, apo kush beson kështu është pa besimtar, kurse të bëhet tekfir personi i caktuar apo disa persona, patjetër që duhet kthyer tek gjykatat sheriatike dhe njëkohësisht duhet vërtetuar një gjë të tillë kundër tyre, po.

3. **Pyetje:** A lejohet për studentin e këtij universiteti të marr dituri përmes internetit, dhe thotë: E kemi këshilluar mirëpo ai e arsyeton këtë me pretekst së disa dijetar e kanë lejuar?

Përgjigjja: Nuk merret dituri nga interneti, as nga kasetat, e as nga librat, dituria merret nga dijetarët, dituria merret duke e transmetuar nga të tjerët, patjetër që duhet interpretuar nga dijetarët.

Sikur të kishte qenë së dituria merret nga librat apo nga diçka të ngjashme më to, nuk do të udhëtonin dijetarët në të kaluarën tek dijetarët tjerë për të mësuar dhe për të transmetuar prej tyre diturinë.

All-llahu i Lartësuar, thotë:

وَمَا كَانَ الْمُؤْمِنُونَ لِيَنفِرُوا كَآفَّةً فَلَوْلَا نَفَرَ مِن كُلِّ فِرْقَةٍ مِّنْهُمْ طَائِفَةٌ لِّيَتَفَقَّهُوا فِي الدِّينِ وَلِيُنذِرُوا قَوْمَهُمْ إِذَا رَجَعُوا إِلَيْهِمْ لَعَلَّهُمْ يَحْذَرُونَ

“Nuk është e nevojshme të dalin në kërkim të diturisë (në një koment në luftë) të gjithë besimtarët. E përse nga çdo grumbull i tyre të mos shkojë një grup për t'u aftësuar në diturinë fetare, për ta mësuar popullin e vet kur të kthehet te ata, në mënyrë që ata të kuptojnë (e të ruhen)”³⁵.

Patjetër që duhet udhëtuar për tek dijetarët, për tek universitetet dhe fakultet shariatike, për të mësuar diturin shariatike ku do që gjendët, nuk mjafton vetëm të shikoi, apo të dëgjoi disa kaseta apo diç tjetër, në këtë mënyrë ai përfiton vetëm disa dobi, kurse të mendoj që mund të bazohet dhe ta konsideroj vetën dijetarë, ky është gabim i madh, po.

³⁵ (Teube 122)

4. **Pyetje:** Shumë pyetje kanë të bëjnë me fotografimin, cili është gjykimi në lidhje me fotografimin me video dhe celular?

Përgjigjja: I Dërguari salAll-llahu alejhi ue sel-lem e ka ndaluar fotografimin në përgjithësi, nuk ka përcaktuar aparatet përmes së cilit bëhet fotografimi, nuk ka përcaktuar ndonjë mjet, qoftë me dorë, skulpturë apo fotografi, gjitha këto i përfshin fotografia, po ashtu edhe njerëzit e quajnë fotografi, gjithë njerëzit e quajnë kështu, çdo gjë që është fotografi konsiderohet haram, përveç nëse është e domosdoshme atëherë lejohet aq sa është e domosdoshme, po.

5. **Pyetje:** Në shumë pyetje pyesin në lidhje me çështjen e ilahive?

Përgjigjja: Falënderimi i takon All-llahut, kasidet islame nuk kanë qenë të njohura në të kaluarën në këtë formë, duke organizuar grupe njerëzish, me zëra melodik, duke i thyer fjalët për shkak të joshjes, duke i joshur dëgjuesit, kjo nuk ishte e njohur asnjëherë, përveç tek sufitet, të cilët kasidet i konsiderojnë pjesë e adhurimit, apo tek hizbit dhe pasuesit e grupacioneve të cilët thërrasin për tek grupacionet e tyre përmes këtyre kasideve, po.

6. **Pyetje:** A lejohet dhurimi i shpërblimit dikujt tjetër, duke thënë: unë falna, agjëroi, lexoj Kur'an pastaj them: O All-llahu im! Shpërblimin e kësaj ia dërgoi filanit?

Përgjigjja: Dhurimi i shpërblimit lejohet aty ku ka argumente për të, në esencë shpërblimi i takon atij që punon:

وَأَنْ لَّيْسَ لِلْإِنْسَانِ إِلَّا مَا سَعَى

“Dhe se njeriut nuk i takon tjetër vetëm se ajo që ka punuar” ³⁶

lejohet dhurimi i shpërblimit të disa veprave për vëllain që është gjallë apo i vdekur, varësisht prej argumentit, lëmosha për tjetrin, dua, kërkitimi i faljes për muslimanin, haxhi apo umreja, kurbanit për të vdekurin, për këto gjëra ka argumente, kurse për diçka tjetër nuk ka, çdo kujt i takon puna e vet, po.

³⁶ (Nexhm 39),

7. **Pyetje:** A është besmelja pjesë e el-Fatihës? Nëse është prej saj, kur njeriu falet dhe nuk e këndon a priset namazi sepse kjo konsiderohet mos lexim i el-Fatihës?

Përgjigjja: Mendimi me i saktë është se besmelja është ajet prej ajeteve të Kur'an-it, ajet i pavarur, nuk është prej el-Fatihës dhe as prej sureve tjera, mirëpo lexohet në fillim të sureve, në fillim të sureve, me përjashtim disa raste ku përmendet gjatë ndonjë sure, si p.sh.:

إِنَّهُ مِنْ سُلَيْمَانَ وَإِنَّهُ بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

“(e lexova) Kjo është prej Sulejmanit (mandej e hapi, kur qe, në të) "Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!" (Bismil-lahir-Rrahmanir-Rrahim!)”³⁷.

Përndryshe ajo është hyrje e sureve, me përjashtim në suren Teube, kjo sure nuk e ka në fillim, pra nuk është prej el-Fatihës dhe as prej sureve tjera. Leximi i saj në namaz është sunet, lexohet në heshtje pastaj lexohet el-Fatiha.

Pejgamberi salAll-llahu alejhi ue sel-lem dihet që nuk e ka lexuar me zë, ky është suneti i tij, me zë e ka lexuar el-Fatihën.

Njeri nga sahabët, ka thënë: **“Jam falur pas të Dërguarit, pas Ebu Bekrit dhe Umerit namazin e fillonin me el-Fatiha”**, kjo tregon se ata nuk e kanë lexuar me zë besmelën, sikur të ishte pjesë e el-Fatihës do ta lexonin me zë, pra kush nuk e lexon fare namazi i tij është i plotë, mirëpo e ka lënë një sunet prej suneteve, prej suneteve të namazit, po.

³⁷ (Neml 30)

8. **Pyetje:** Shumë pyetje kërkojnë këshill prej teje në lidhje me disa të rinj që nuk janë martuar dhe kanë vështirësi, kërkojnë këshillë për këtë?

Përgjigjja: Ata duhet të martohen sa më parë nëse i kanë mundësit, Pejgamberi, salAll-llahu alejhi ue sel-lem, ka thënë: "O ju të rinj kush ka mundësi prej juve që të martohet, le të martohet, ngase kjo e ruan shikimin dhe nderin, kush nuk mundet atëherë le të agjëron, ngase agjërimi është mburojë për të", agjërimi e zvogëlon epshin apo e dobëson, All-llahu i Madhërishëm, thotë:

وَلْيَسْتَغْفِرِ الَّذِينَ لَا يَجِدُونَ نِكَاحًا حَتَّى يُغْنِيَهُمُ اللَّهُ مِنْ فَضْلِهِ

"E ata që nuk kanë mundësi martese, le të përmbahen derisa All-llahu t'i begatojë me të mirat e veta..."³⁸, po.

9. **Pyetje:** Cili është kuptimi i fjalës së Ibën Sirinit: "**Më të vërtetë kjo dituri është fe, andaj shikoni nga kush e merrni fenë tuaj**"? Sipas kësaj a duhet që ta dimë gjendjen e njeriut dhe pastaj të marrim dituri prej tij?

Përgjigjja: Po, kjo është ashtu siç ju kemi thënë, dituria nuk merret nga letrat, nga kasetat apo nga faqet elektronike, mirëpo merret nga dijetaret duke e mësuar prej tyre. Po ashtu, jo prej çdo dijetari, përkundrazi kërkuesi i dijës duhet t'i zgjedh mësimdhënësit e tij, ata që janë besnik në fe dhe dituri, pastaj merr dituri prej tyre, po.

10. **Pyetje:** Hyra në xhami dhe imami sapo kishte filluar namazin, safin e tretë e kishin radhitur nga ana e majtë, në mes të xhamisë nuk kishte asnjë njeri në saf, a duhet të radhitna pas tyre apo pas imamit në safin e tretë?

Përgjigjja: Nëse e gjen xhematin duke u falur, falu me ta, qofshin ata pas imamit, në të majtë apo në të djathtë, radhitu me ta, ngase ata janë radhitur në saf dhe ti bashkohu me ta, po.

³⁸ (Nur 33)

11. **Pyetje:** A lejohet për gruan të del për davet pa mahrem (kujdestar)?

Përgjigjja: Së parit ta këshillon vetën, ta këshillon vetën, si të dal për davet pa mahrem?! I Dërguari salAll-llahu alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Nuk lejohet për një grua që beson All-llahun dhe Ditën e Fundit që të udhëtoi pa mahrem”**, në një transmetim tjetër thuhet: **“Në distancë dy ditore”**, në një transmetim tjetër: **“Në distancë tre ditë”** që do të thotë: udhëtim me kafshë, kurse në një transmetim tjetër: **“Në distancë një ditë dhe një natë”**, në një transmetim tjetër të përgjithshëm: **“Të udhëtoi veçse më mahrem”**.

Në qoftë së dëshiron të bëjë davet, së parit lë të vepron sipas fjalëve te të Dërguarit salAll-llahu alejhi ue sel-lem, po.

12. **Pyetje:** Cila është këshilla juaj për atë që shoqërohet me njerëz të pamoralshëm, përgojuës, bartës të fjalëve, disa here e kemi këshilluar, mirëpo nuk është përmirësuar, a lejohet të shoqërohet me të apo jo?

Përgjigjja: Nuk bënë të shoqërohet me të, përderisa bartë fjalë, përgojon dhe i nënvlerëson njerëzit nuk duhet shoqëruar, ngase mund të ndikohet prej tij, ngase shoqëruesi i keq ndikon tek shoku i tij, ashtu sikur shoqëruesi i mirë që ndikon tek shoku i tij.

Pejgamberi, salAll-llahu alejhi ue sel-lem, ka thënë: **“Shembulli i shoqëruesit të mirë dhe të keq është sikur ai që punon me miska (aroma)...”**.

Pra, shembulli i të mirit është sikur ai që punon me miska, prej tij ose blen, apo të jep misk, apo e shijon aromën e miskut gjatë kohës sa qëndron me të, pra ti nuk e humb aromën e mirë përderisa qëndron me të mirin, shembulli i shoqëruesit të keq është sikur aroma e farkëtarit, ose ti djeg rrobat, ose ndien kundërmimin e aromës së keqe prej tij, po.

13. **Pyetje:** Ngritja e rrobave deri në sa'ak (pak përfund gjurit apo përafërsisht një pëllëmbë), a konsiderohet si veçim nga të tjerët?

Përgjigjja: Në vendin ku nuk praktikohet kjo, mirëpo rrobat i mbajnë deri përmbi nyje të këmbës, po, konsiderohet veçim, ngase edhe ata të cilët i mbajnë deri përmbi nyje janë sipas sunetit, përderisa është sunet bashkoju atyre edhe ti, mos i kundërshto, ngase ata me këtë e praktikojnë sunetin, elhamdu lil-lah!

Mirëpo nëse ata i lëshojnë poshtë njejve, ti mos vepro ashtu, kjo nuk lejohet edhe nëse shumica veprojnë ashtu, ngase kjo është në kundërshtim me sunetin, po.

14. **Pyetje:** Një njëri i ka thënë një personi, nëse me mund, t'i jap njëqind rijal, kurse tjetri nuk ka kushtëzuar asgjë, do të thotë kushti ka qenë vetëm nga njëra palë, a lejohet kjo i nderuari shejh?

Përgjigjja: Për çfarë arsye ta mund? Kushti nuk lejohet, marrja e pasurisë nuk lejohet përveç aty ku e ka përjashtuar i Dërguari salAll-llahu alejhi ue sel-lem: "**Nuk ka shpërblim**", që do të thotë s'ka shpërblim përveç në tre gjëra: Më gara me shtiza, gara me kuaj kur ushtrojnë për xhihad apo me deve, lejohet marrja e shpërblimeve për këto. Disa i kanë lejuar shpërblimet në gara të diturisë apo fik'hut dhe mëmORIZIMIT të Kur'an-it, më arsye së kjo bënë pjesë në kategorinë në rrugën e All-llahut.

Ngase kërkimi i diturisë është xhihad në rrugën e All-llahut, përveç këtyre tre gjërave nuk lejohet marrja e shpërblimeve, sepse konsiderohet ngrënie e pasurisë pa të drejtë, lloj bixhozi, që do të thotë përfitim përmes garës, me përjashtim të asaj që e ka lejuar i Dërguari salAll-llahu alejhi ue sel-lem.

All-llahu i Lartësuar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَأْكُلُوا أَمْوَالَكُمْ بَيْنَكُمْ بِالْبَاطِلِ إِلَّا أَنْ تَكُونَ تِجَارَةً
عَنْ تَرَاضٍ مِنْكُمْ

"O ju që besuat, mos e hani mallin e njëri-tjetrit në mënyrë të palejuar, përpos tregtisë në të cilën keni pajtueshmëri mes vete..."³⁹, po.

³⁹ (Nisa 29)

15. **Pyetje:** Një imam ka falur namazin me xhemat, pak para selamit i është kujtuar së është falur pa abdes, si duhet të veproj, a duhet ta zëvendësoi dikush tjetër, a duhet të largohet?

Përgjigjja: Nëse nuk i kujtohet përveç së pas selamit, namazi i tyre është i vlefshëm, kurse ai duhet ta përsëris, merr abdes dhe e përsërit namazin, nëse i përkujtohet gjatë namazit, e ka obligimi të largohet. Duhet të largohet, duhet të largohet, mos të vazhdon në namaz, merr abdes dhe ja rifillon namazit më xhemat, po.

Po ashtu e vendos dikën tjetër në vend të vetin, dike që ua plotëson namazin, pastaj shkon dhe merr abdes, nuk e vazhdon namazin ashtu, pa abdes, ngase namazi i tillë është i zhvleftësuar si dhe i atyre që falen pas tij, nëse vazhdon të falet pa abdes, namaz i të gjithëve është i zhvleftësuar.

16. **Pyetje:** Transmetohet në një hadith se Pejgamberi, salAll-llahu alejhi ue sel-lem, ka thënë: “**Melajket nuk i shoqërojnë ata që kanë qen dhe zile**” ai i cili dëgjon muzikë gjatë udhëtimit a hyn në këtë hadith, bazuar në fjalën “**Zile**”?

Përgjigjja: Sa i përket dëgjimit të muzikës është shumë me e rënd, dëgjimi i muzikës, muzika është haram, nuk lejohet, posaçërisht nëse është e shoqëruar me tinguj apo instrumente argëtimi kjo është shumë më e rënd, muslimani nuk duhet të dëgjoj, po.

17. **Pyetje:** Shumë prej pyetjeve janë të një tematike, në lidhje me ata që flasin kundër dijetarëve kërkojnë nga ti këshillë në lidhje me këtë?

Përgjigjja: I këshilloj me frikë ndaj All-llahut të Plotfuqishëm, mos t’i nënçmojnë askënd nga muslimanët në përgjithësi. Muslimani e ka nderin e tij edhe në qoftë së është nga shtresa e ultë e muslimanëve, e si nëse nënçmohen dijetarët? Ata duhet t’i frikësohen All-llahut, edhe nëse dikush prej dijetarëve gabon, prapë nuk lejohet me fol kundër tyre apo me i përgojuar, përkundrazi duhet informuar që kanë gabuar dhe duhet sqaruar gabimin e tyre, kështu që njeriu e hekë përgjegjësin prej vetes dhe nuk i përgojon, po.

18. **Pyetje:** A lejohet për ata që jetojnë në Evropë që t'i shkurtojnë mjekrat, ngase shkak i mjekrës kanë problem të punësohen?

Përgjigjja: Përmbaju sunetit në çdo vend, mos shiko së si t'i kënaqësh njerëzit apo së çfarë thonë ata, përmbaju sunetit në çështje të mjekrës si dhe në çështje tjera, mos lësho pe në asgjë nga feja jote për shkak të dëshirave të njerëzve, kjo është prej lajkave të ndaluara, po.

